



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 17 datë 06/03/1995

**PER
RRITJEN E PAGAVE TE KESHILLIT DREJTUES TE DISA
NDERMARRJEVE LOKALE TE INDUSTRISE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranë, në mbledhjen e tij të dt.06.03.1995, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Seksioni Prognozës për rritjen e pagave të Këshillave Drejtuese të disa Ndërmarrjeve Lokale të Industrisë, në zbatim të Vendimit të Këshillit Ministrave Nr.463, dt.03.10.1994 dhe të udhëzimit Nr.2185, dt.12.12.1994, të Drejtorisë së Pagave dhe Mardhënieve të Punësimit të Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë dhe të ligjit “Për Ndërmarrjet Shtetërore” Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.5 dhe të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10

V E N D O S I

1. Pagën :

- 1.Për drejtorin e Ndërmarrjes Prodhimeve Artistike “Artir”. Paga mujore u vendos 7.500 lekë në muaj.
 - 2.Për drejtorin e shtypshkronjës “Çajupi”. Paga mujore u vendos 8.000 lekë në muaj.
 - 3.Për drejtorin e Ndërmarrjes Riparimeve Materialeve Poligrafike. Paga mujore u vendos 3.000 lekë në muaj.
2. Për anëtarët e Këshillit Drejtues të Ndërmarrjeve të mësipërme paga e tyre mujore vendoset 12 – 20 përqind më e vogël se paga e drejtorit.

3. Drejtori i Ndërmarrjes dhe anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues përfitojnë rritje mbi pagën 5 deri në 70% në të njëjtën masë që do të përfitojnë dhe punonjësit e tjerë të Ndërmarrjes.
4. Këto paga do të do të zbatohen nga 1 Tetori i vitit.

KRYETARI

BESNIK PETRELA